

**“LIBRI I BURGUT” I ARSHI PIPËS
DHE POEZIA E BURGUT (1944-1990)**

Sali BYTYÇI
Intituti Albanologjik
Prishtinë

Punim studimor

Përmbajtje e shkurtër: Letërsia shqiptare e gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë përveç anës zyrtare kishte edhe anën jozyrtare, përveç anës së dukshme kishte edhe anën e fshehur.

Pra, kjo letërsi kishte edhe *anën tjetër*.

Krahas letërsisë së realizmit socialist, që u instalua pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri si letërsi zyrtare, u krijua edhe një letërsi tjetër, që nuk kontrollohej nga dogma ideologjike. Kjo letërsi kryesisht ishte letërsia e burgut, letërsia e sirtarëve dhe letërsia e ndaluar - më pak, që u krijuan në vend, si dhe letërsia e diasporës.

Nëse letërsia e realizmit socialist ndërpret kontinuitetin e letërsisë shqipe, letërsia e burgut, letërsia e sirtarëve dhe letërsia e diasporës janë letërsi të vazhdimësisë së letërsisë shqipe të viteve '30-'40 të shekullit të kaluar.

Pas luftës, arti e sidomos letërsia, qe detyruar të ishte në anën e atyre që kishin dalë fitues në këtë luftë, dhe në emër të së cilës kishin marrë pushtetin. Krijuesit letrarë konsideroheshin punonjës shpirtërorë, “inxhinierë të shpirtit”, që do të ndihmonin në krijimin e njeriut të ri.

Ishte kjo një letërsi e orientuar dhe, në kohën kur të orientuarit gëzonin respektin e ideologëve të shoqërisë së re të njerëzve “të barabartë”, ata që nuk ishin në rrugën e orientuesve dënoheshin nga pushteti, hynin në radhën e armiqve të pushtetit, sepse në pushtetet diktatoriale kishte vetëm dy rrugë: me pushtetin ose kundër tij, rrugë të tretë nuk kishte.

Në këtë kohë u krijua edhe letërsia e burgut sepse, që me instalimin e diktaturës në Shqipëri, me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, e deri në rënien e komunizmit në fillim të viteve '90, në mesin e shtresave të tjera, që nga kriminelët e luftës, të deklasuarit, ordinerët etj., një prani të përhershme në burg kishin edhe shkrimtarët, një pjesë e të cilëve edhe nuk arritën të mbijetonin, duke filluar nga të fundit e Rilindjes Kombëtare, si Ndoc Nikaj, Bernardin Palaj, Vinçenc Prendushi, Mirash Ivanaj, pastaj Arshi Pipa, Kasem Trebeshina, Lazër Radi, Kudret Kokoshi, Trifon Xhagjika, Genc Leka, Vilson Blloshmi, Havzi Nela, Frederik Rreshpja, Pano Taçi, Maks Velo, Zyhdi Morava, Visar Zhiti; në Kosovë Adem Demaçi, Fazli Greiçevci (vdiq në burg nga torturat), Xajë Nura, Adem Gajtani, Teki Dërvishi, Beqir Musliu, e deri te brezi i vitit 1981, si Hydajet Hyseni, Merxhan Avdyli, Januz Januzaj, Bajram Kosumi, si dhe të burgosurit e viteve 90, e të luftës së UÇK-së, 1997-1999.

Në këtë punim studimor do të ndalemi te poezia e burgut e Arshi Pipës.

Fjalë çelësa: letërsia, realizmi socialist, ana tjetër, letërsia e burgut, kontinuiteti, arti, Lufta, komunizmi etj.

Hyrje

Libri i parë poetik i një të burgosuri në letërsinë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë është “Libri i burgut” (Romë, 1959), i Arshi Pipës.

Para se të burgosej, Arshi Pipa (Shkodër 1920 - SHBA 1997) kishte botuar vëllimin poetik “Lundërtarë” (shtypshkronja “Tirana”, Tiranë, 1944), si dhe shumë vështrime studimore për letërsinë shqipe.

Në poezitë e “Librit të burgut” poeti jep jetën e tij, po edhe të bashkëvuajtësve, gjatë burgimit 10-vjeçar në burgje të ndryshme të Shqipërisë, ndërsa në disa poezi të veçanta “del” jashtë burgut duke trajtuar tema: historike, folklorike, po edhe filozofike – meditime për jetën e vdekjen, për pavdekësinë etj.

Ndërsa krijimet e sivëllezërve të Pipës, deri në vitet '90, ngelën në sirtarët e Sigurimit të Shtetit apo në sirtarët e tyre personalë, “Libri i burgut” pati fatin të botohej jashtë Shqipërisë. Kështu, ky libër, të cilin kishin pasur mundësi ta lexonin vetëm shqiptarët jashtë atdheut, bëri jetën e vet edhe përgjatë kohës së diktaturës.

Shumica e poezive të vëllimit poetik “Libri i burgut” të Arshi Pipës janë kronologji e jetës në burg. Këtu, rrjedhën e jashtme të jetës në burg e shoqëron mendimi i subjektit lirik, që në fakt është subjekti poetik, ai që

e përjeton këtë jetë. Poeti, në paraqitjen e tij lexuesit, thotë: “Lexuesi qi shfleton këtë libër, e vëren si çdo tjetër libër, shef vargjet e radhituna ndër strofa e kapituj, si ushtarë të dishiplinuem ndër togje dhe regjimente: shef paradën e ksaj ushtrie vargjesh, jo luftën, jo “guerilla-n” e saj”,¹ duke sqaruar se këto vargje nuk janë shkruar si zakonisht shkruhen vargjet – në tryeza, në dhoma të pastra e të ngrohura nga stufa apo nxehja qendrore etj.

1. Struktura e jashtme e librit

Struktura e jashtme e “Librit të burgut” të Arshi Pipës përbëhet nga Paraqitja, Poezitë, Shënimet, Fjalorthi dhe, në fund, Nota e falënderimi.

Në krye të librit qëndron kushtimi: “Dëshmorëve të kombit qi ranë kundër komunizmit me nderim auktori kushton”.

a) **Paraqitja.** -Në fjalën në fillim të “Librit të burgut”, “Paraqitje”, që si vëllim ka pak më shumë se dy faqe tekst, autori ia paraqet librin lexuesit. Aty ai tregon arsyen e krijimit të këtij libri, mënyrën e krijimit, arsyetimin përse e shkroi në vargje e jo në prozë, mendimin për këtë libër etj.

kjo nuk ndodhi gjithmonë për mungesë karte”.²

b) **Poezitë.** -Poezitë në “Librin e burgut” autori i ka strukturuar në nëntë pjesë të madhësive të ndryshme.

Përveç pjesës së parë dhe të fundit që u shkruan jashtë (e para në Tiranë, e nënta në Shkodër), të gjitha pjesët janë shkruar në burg dhe janë emëruar sipas shtrirjes kronologjike dhe burgjeve nëpër të cilat ka kaluar poeti përgjatë dhjetë vjetëve të burgimit të tij (1946-1956).

Libri hapet me poezinë për Mujo Ulqinakun dhe mbyllet me poezinë për revolucionin antikomunist hungarez të vitit 1956, të cilën poeti e kishte shkruar pas daljes nga burgu, por që është në frymën e poezive të burgut.

c) **Shënimet.** -Një pjesë të madhe të poezive poeti i shoqëron me shënime, në të cilat tregon kohën kur i ka shkruar, rrethanat në të cilat janë shkruar, pozicionin prej të cilit janë shkruar, p.sh. ballkon etj., ngjarja që e ka frymëzuar, por jep edhe sqarime për “personazhe” të poezive, jep shënime historike për to etj.

¹ Arshi Pipa, *Poezi*. “Dukagjini”, Pejë 1998, f. 281.

² Po aty, f. 243.

Për ribotimin e librit më 1994, autori kishte shkruar edhe një pas-thënie, në të cilën tregon për mënyrën se si e kishte nxjerrë librin nga burgu, të cilin e kishte shkruar në letra cigareshe e që, pastaj, duke i qepur në rrobat të cilat i merrte motra për t'i larë, e kishte nxjerrë jashtë: “Fatmirësisht letërkëmbimi i fshehtë nuk u diktua, dhe kështu poezitë mundën me u rrujtë, tue u transkriptue ma vonë në një fletore. Letërcigaret janë rrujtë, dhe gjinden në një sepet, bashkë me të tjera sende të çmueshme, në shtëpinë e motrës në Washington D.C.”.³

ç) Fjalorthi. Pas Shënimeve, Pipa bëri edhe një fjalorth, në të cilin i shpjegon fjalët më pak të njohura që i përdor në poezitë e veta. Në Vërejtjen që jep në krye të Fjalorthit, shkruan: “Fjalët e rralla të këtij fjalorthi janë, në pjesë më të madhe, të ndëgjueme prej vetë auktorit në të folunit e popullit. E shumta e tyre janë të qytetit të Shkodrës – në fjalorth kto fjalë shënohen me shkurtesën (shk.). Të tjerat fjalë të rralla janë të nxjerruna nga fjalorë të ndryshëm të Shqipërisë: Fjalorthi i Gazullit, Fjalori i “Bashkimit”, “Fjalori i Gjuhës Shqipe” i Institutit të Shkencave, etj.”.⁴

Në fund sqaron se fjalëve të gjuhëve të huaja, përbri u është shënuar edhe gjuha origjinare, si dhe jep edhe tabelën e shkurtesave të gjuhëve si fr. (frëngjisht), gr. (greqisht), gjr. (gjermanisht) etj.

Në fund vë Notën falënderuese, me të cilën i falënderon të gjithë ata që kanë dhënë kontribut në botimin e librit.

2. Poezia

Në veprën poetike të Arshi Pipës, numri më i madh i poezive të tij, ashtu si edhe te poetët tjerë shqiptarë, pararendës të Pipës, janë ato që ndërlidhen me atdheun: dashuria ndaj atdheut, përkushtimi, historia, e tashmja e atdheut kur në pushtet kishin ardhur komunistët etj.; pastaj poezitë në të cilat “rrëfen” jetën në burg; poezitë për poezinë; poezitë meditative, të cilat në thelb kanë filozofinë stoike; poezitë që kanë bazën në folklor etj.

Arshi Pipa është poeti i cili formën klasike të të krijuarit poezi e mbushi me përmbajtje nga jeta e burgut individual dhe kolektiv të shqiptarëve pas Luftës së Dytë Botërore.

³ Arshi Pipa, *Libri i burgut*, Tiranë 1994, shënim në kopertinën e pasme.

⁴ Arshi Pipa, *Poezi*. “Dukagjini”, Pejë 1998, f. 447.

a) Politika e atdheu në poezinë e Pipës

Në poezitë e librit të Pipës për burgun, për të ndodhurat aty, për ato që i përjeton poeti dhe shokët e tij, përvijohen dy tema të pandara nga njëra-tjetra: politika e atdheu, sepse, në fund të fundit, qëndrimet politike nga duhej të shkonte Shqipëria, të cilat i kishte mbajtur gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, ishin bërë shkas që Arshi Pipa të burgosej pas përfundimit të luftës, prandaj edhe politika zë një vend të veçantë pothuaj në tërë librin e tij të burgut.

Gjatë leximit të këtij libri, në imagjinatën e lexuesit, indirekt, krijohet edhe portreti politik e patriotik i poetit Arshi Pipa, i cili jo vetëm si krijues që është vazhdues i denjë i letërsisë së viteve '30, por edhe si njeri është vazhdues i atyre shqiptarëve të cilët, kur është fjala për çështjen kombëtare, i tejkalojnë ndarjet ideologjike dhe krahinore. Pipa është antifashist, por në të njëjtën kohë është edhe antikomunist, ai është nacionalist, shqiptar që nuk mashtrohet nga interesat politike të çastit.

Përmes “historive” në të cilat rikujton ngjarje të ndryshme, të afërta e të largëta, jepen qëndrimet politike të poetit. Kështu, që në poezinë e parë të librit, e cila i kushtohet Mujo Ulqinakut, jepet qëndrimi i autorit ndaj ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse me një stil ndryshe, po me mesazh të njëjtë, kjo poezi të kujton poezinë e Petro Markos për Shtatë Prillin 1939, ditën kur Italia fashiste e sulmoi Shqipërinë.

Hapja e poezive të tij me një ngjarje nga Lufta e Dytë Botërore (Mujo Ulqinaku), luftë të cilën e shkaktoi nazi-fashizmi, lë të kuptohet se fajtor për ngadhënjimin e socializmit në shumë vende të Evropës, e edhe në Shqipëri, ishte pikërisht ky i fundit.

Poeti e ngre lart aktin heroik të Mujo Ulqinakut, të cilin e bën njësh me heronjtë e këngëve kreshnike. Edhe krijimi i kësaj poezie është në frymën popullore.

Ndërsa në poezinë e dytë të kësaj pjese, “Legjenda e Drenicës”, poeti “rrëfen” historinë e një djaloshi nga Drenica, i cili, edhe pse ende pa i mbushur të pesëmbëdhjetat, pasi i vriten dy vëllezërit, vendos të rrokë pushkën kundër armikut.

Në këtë poezi, në bazë të imazhit të armiqve, kuptohet koha: është Lufta e Dytë Botërore, kur po bëhej luftë në Drenicë kundër shqiptarëve të cilët ishin që Kosova t’i kthehej trungut nga ishte shkëputur më 1913. Pas kundërshtimit të nënës, një zë i thotë asaj ta lërë djalin të shkojë në luftë:

*“Lene, nanë! Ma keq me u mbyllë:
ktu me e gjete si berr e presin,
Shqe veç janë, me hyll pa hyll,
Qymen kanë ndërrue, jo vesin.”⁵*

Ashtu, siç fillon kjo poezi, edhe mbyllet. Ndërsa në fillim, murrllani i çmendur ulërin e fshan si të kishte shigjetën në bri, e megjulla davaritet mbi katundin shkumb e hi, në strofën e fundit, murrllani që fishkëllen e shkon duke uturuar nëpër shkëmbinj: “hyn ndër hekrat e dritores/ nalt te kulla shkumb e hi”.⁶ Djegia e kullës tregon edhe epilogun e luftës së Drenicës, e cila u shtyp me gjak dhe Kosova edhe një herë mbeti në roberinë sllave.

Kjo pjesë përmbillet me poezinë “Kosovës”, poezi me njëmbëdhjetë strofa, me rimë të alternuar. Ndoshta është ndër të parat, apo edhe e vetmja poezi, e shkruar për Kosovën në kohën kur Shqipëria e Jugosllavia, si dy vende komuniste, në vitet e para pas Luftës po jetonin sikur të ishin një vend:

*Vllazën shqiptarë, Kosova s asht e jona.
Kush me e përmendë guxon ai ban tradhti!
O kob qi s do t’harrohet kurrë tevona!
Kosova e ngratë dergjet e vdes n’robni.
(Kosovës)⁷*

Sipas poetit, Kosova është e tradhtuar prej bijve bastardë, të cilët pas Luftës së Dytë Botërore kaluan në anën e Bashkimit Sovjetik, i cili, dihet, si shtet sllav, sllavët do t’i përkrahte.

Për Arshi Pipën, Kosova është vendi në të cilin lindi Shqipëria, duke aluduar kështu në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, në të cilën u projektuan kufijtë e Shqipërisë së ardhshme. Kjo poezi na kujton edhe librin e Hamit Kokalarit: “Kosova, djepi i shqiptarizmit”. Pra, Pipa është në vazhden e patriotëve shqiptarë të Rilindjes Kombëtare e të atyre të viteve ’30, por është edhe në vazhden e politikës së Ballit Kombëtar, për çfarë edhe ishte akuzuar dhe burgosur nga pushteti komunist pas luftës.

⁵ Po aty, f. 253.

⁶ Po aty, f. 255.

⁷ Po aty, f. 255.

Për poetin Kosova është tokë shqiptare që nga koha antike, sepse në territorin e saj dikur ishte Dardania:

*O tokë e bukur ku fjala burrneshë
ilire ushton qysh me mjegull gojdhane!
gjoks i shqipes, ku e ndrymë si luaneshë
ndër hekra gjëmon zemra Dardane!*⁸

Poeti, me vargje epike e elegjiake, e vajton Kosovën të mbetur nën pushtetin sllav, apo siç thotë, në “vulën e dhunës/ qi t’la mbi vetulla kam-xhiku sllav”.⁹

Sipas poetit, Kosova është gjymtyrë e atdheut, është vend martir.

Poezia përfundon me thirrjen që poeti u bën shqiptarëve, të mbajnë ballin lart, se prej Kosovës e deri në Çamëri është Shqipëria!

Në poezinë me katër pjesë, “Nemesis” (nëma), jepen tmerret që i përjetojnë të burgosurit në burgjet komuniste menjëherë pas marrjes së pushtetit të këtyre të fundit. Këta janë të burgosur politikë, sepse kanë kundërshtuar politikën e pushtetarëve të rinj. Në thelbin e ndeshjes është lufta klasore. Ndarja komunistë-nacionalistë këtu është e qartë. Me ngadhënjimin e komunistëve, të cilët marrjen e pushtetit e mbështetin në luftën që kanë bërë kundër fashizmit, nacionalistët burgosen dhe akuzohen për tradhti.

Në këtë poezi, me radhë, përshkruhen mënyrat e torturimit që u bëhen këtyre të burgosurve: shkulja e thonjve, hedhja kripë në plagë, lagia me ujë e qelive gjatë dimrit, vënia e jelekut torturues dhe lënia varur për orë të tëra e të burgosurve me këtë jelek etj., e që janë vetëm disa nga torturat që u bëhen të burgosurve. Ndonjë që u shpëton këtyre torturave, pushkatohet dhe varroset në vende të fshehta, në vende të cilat familja nuk do t’i mësojë kurrë, duke mos pasur kështu mundësi që së paku t’ia nderojë varrin! Në një situatë të tillë poeti shpërthen:

*Kushtrim, o male, o fusha! Qitni ben
ksaj zgjedhe fund me i dhanë!*

*ta zhbijmë krajatën qi na e bani atdhen
veç burg e kasaphanë!*¹⁰

⁸ Po aty, f. 255.

⁹ Po aty, f. 255.

Në pjesën e dytë të poezisë, poeti u kthehet rrënjëve të së keqes, të cilat i gjen te fillimi i luftës së Dytë Botërore, me ç'rast Shqipëria ishte ndër të parat vende që u pushtua nga fashizmi. Në fund, nga lufta që i bënë forcat demokratike të botës, ra fashizmi po, sipas poetit, fashizmi i zi ra, po doli në shesh fashizmi "i kuq". Sipas poetit, me këmishë apo pa këmishë (kujto: këmishëzinjtë!), fashizmi mbetet fashizëm:

*Ngeli foleja tjetër.
Fashizmi i kuq andej tash nxori kokët
e zu me ngulun kthetër.¹¹*

Ujku nuk bëhet dele duke e ndërruar lëkurën, as diktatura komuniste demokraci nuk bëhet kurrë, prandaj poeti u bën thirrje njerëzve të mos i besojnë propagandës komuniste, se nuk po vihet një rend i ri e i drejtë shoqëroro, po një rend shtypës. Jo rrallë, vargjet e poetit na e kujtojnë poezinë romantike evropiane të shekullit të nëntëmbëdhjetë, në të cilën bëhet thirrje për liri dhe dinjitet njerëzor. Kështu, poezia kthehet në himn dhe njëkohësisht, kushtrim për të luftuar për liri, për një luftë jetë a vdekje!

Në pjesën e tretë, poeti bën thirrje që njerëzit të çlirohen nga ndjenjat, të kthehen në makina kundër regjimit që po vendosej në Shqipëri. Shkule zemrën dhe kërko hakmarrje, kjo është deviza e poetit. Tani ai krijon Librin e urrejtjes, sepse pos urrejtje, në këtë kohë nuk mund të ketë diçka tjetër.

Me epitetet më negative poeti i cilëson njerëzit e pushtetit të pasluftës: bastardë të fisit, që ngulën thikën bolshevike aty ku patën thithur sisë; që mburrin haxhi qamilat:

*Mbi gjithë ata qi vetëm përbindshi i mnershëm
i xhehenemit sovjet
ndërsen kundër gjithë njerëzve të ndershëm
qi duen atdheun e vet.¹²*

¹⁰ Po aty, f. 284.

¹¹ Po aty, f. 285.

¹² Po aty, f. 287.

Mendon me çfarë emri t’i emërtojë njerëzit të cilët kanë vendosur këtë rend diktatorial, po pasi nuk gjen një emër më të urryer, në fund vendos t’i emërtojë thjesht “komunistë”.

Arsyeja e burgosjes së poetit dhe shokëve të tij është sepse e deshën Shqipërinë e plotë, pra atë Shqipëri që nuk është baras me Shqipërinë e vitit 1913! Bën dallimin në mes të atyre që tani quhen tradhtarë dhe të atyre që e kanë marrë pushtetin: njerëz të shtresave të ulëta, të pashkolluar etj. Pra, këtu vërehet qartë se bëhet fjalë për luftën e klasave.

Harta e atdheut të Arshi Pipës nuk është Shqipëria londineze, po është atdheu nga Kosova në Çamëri: “O vllazën, nalt ju ballin! prej Kosove/ deri n’Çamëri Shqipnija asht gjithë e jona”.¹³

Përse luftuan idealistët në Luftën e Dytë Botërore, poeti e thotë në poezinë e parë “Kanga martyre”, të ciklit të tretë, me të cilën u krijon himn njerëzve të cilët u martirizuan me vendosjen e regjimit diktatorial në Shqipëri pas përfundimit të kësaj lufte:

*Luftuem për idealet
e thjeshta kombëtare.
Na ramë, po mbasi mbollëm
Virtytin e një fare
qi jep ndër ju filiza
me gjak e bame plle.
Shqipnija e përtërimë
me vdekjen tonë ka le.*¹⁴

Poeti është i bindur se gjaku dhe vuajtjet e atyre që pësuan nga regjimi komunist, nuk do të shkojnë kot.

Poetit të burgosur, në poezinë e gjatë e me vargje të lira epike, “Kështjelli”, të shkruar në vitin 1950 në kështjellën e Gjirokastrës, i kthehen kujtimet personale, sepse kthehet në vendin e origjinës, në vendin e të parëve të vet, i kujtohen ditët e rinisë, ditët që nuk kthehen më: shumë gjëra i ka shkatërruar koha, të cilat askush më nuk i ndreqi, por edhe më shumë të tjera i shkatërroi lufta qytetare, siç e cilëson Luftën e Dytë Botërore:

¹³ Po aty, f. 256.

¹⁴ Po aty, f. 271.

*E shumta u – dogjën. Nuk u dogj i hueji,
Greku, Italjani, por banori i tyre
gjatë luftës qytetare qi kto vise
t'vorfnueme ma vorfnoi. E sot katundi
nji grumbull asht rrënojesh e kolibash,
nji vend i vdekun qi me pa t'merr vaji.¹⁵*

Poeti, pa marrë parasysh çfarë përjeton në burgjet komuniste, kurrë nuk arrin të bjerë në pesimizëm dhe në pozita ekstreme, siç u ndodh të persekutuarve të komunizmit. Përkundrazi, Pipa kurrë nuk e humb kthjelltësinë mendore:

*Na thonë se sot na miq i kemi Grekët,
se jemi lidhun kundër komunizmit
me ta për nji qëllim!... Shqiptarë a njiçni?
Harruet Hormovën. Kristo Negovanin,
shërbëtorin e Zotit e t'atdheut?¹⁶*

Atyre që bëjnë një propagandë të tillë, poeti ua kujton Hormovën, ku grekët masakruan shumë banorë të saj, pastaj ua kujton Papa Kristo Negovanin “shërbëtorin e Zotit e t'atdheut”, ua kujton eksodin çam! Ai thotë se më parë kalbet në burg e vdes në bodrume, sesa të pranojë lirinë që ia falë armiku!

Këto vargje poeti i shkruan një vit pas ndërhyrjes së ushtrisë greke në kufirin shqiptar, me ç'rast kjo ushtri ishte kthyer prapa me turp!

Atdheu është në rrezik dhe poeti bën thirrje që meritë, si të vjetrat si të rejtat, të lihen anash dhe të bashkohemi ashtu siç u bashkuan shqiptarët kur shpallën pavarësinë më 1912! Sipas poetit, tani rrethanat janë shumë më të favorshme se në atë kohë kur shqiptarët ishin të ndarë në gegë e toskë, në të krishterë e myslimanë, në “turq” e “kaurrë”, në shqiptarë që duan të shkruajnë me fjalor arab ose grek apo sllav! Ata shqiptarë i kishte ndriçuar atdhedashuria dhe, edhe sot atdhedashuria duhet t'i ndriçojë shqiptarët! I ngre himn shpërthimit të shqiptarëve për liri e pavarësi në atë kohë:

¹⁵ Po aty, f. 349.

¹⁶ Po aty, f. 249-250.

*I mrekullueshëm qe ai vrull lirije,
ajo dëshirë e flakët qytenimi,¹⁷*

Ishte ajo kohë kur ishin ngjallur shpresat për një jetë të re dhe shqiptarët i kishin drejtuar sytë nga Perëndimi.

E pranon që shqiptarët nuk janë më të mirë se të tjerët, ata nuk i urrejnë fqinjët për atë që kanë ngelur prapa, por edhe nuk kanë arsye të poshtërojnë veten e tyre duke ulur qafën. Poeti lavdërohet për virtytet që i ka populli shqiptar, po edhe i pranon veset që i ka ky popull:

*Kemi virtyte t’epura qi veç racat
fisnike i kanë. E n’paskemi plot vese
burrnisht i njoftim. Faji ynë qe ndofta
pse katër shekuj rresht n’errsinat ngelëm
e një robnije shterpe prapanike?¹⁸*

Përmend pushtimet romake, sllave e turke, nën të cilat shqiptarët për shekuj qëndruan, po edhe pse shumë popuj u zhdukën, populli ynë u mbijetoi shekujve. Gjatë kësaj kohe humbëm shumë, por nuk humbëm përvarë! Pastaj, kur filloi zgjimi i kombeve në këtë pjesë, shumë prej tyre u ndihmoi Evropa, si p.sh. grekëve, ndërsa shqiptarëve jo:

*E ashtu patën kombinat e Ballkanit
shtylla fuqit e mdha. Na cilin patëm?
Europa na quejti turq, ne nipat
e Skanderbegut! kundër nesh i nxiti
fqinjët i majmi ata me copat tona,
e n’fund grabitjet ua vulosi...¹⁹*

Dhe, në fund, kur s’kishte më çfarë të merrte nga shqiptarët, u fali, siç i falet lypësit, një kockë nga trupi i vet!

Poeti thotë se nuk është idhujtar i fisit, as idhujtar i asgjëje, se mendjen e tij e ka ndriçuar dija;

¹⁷ Po aty, f. 350.

¹⁸ Po aty, f. 351.

¹⁹ Po aty, f. 351.

*s jam idhujtar i kurrnji gjaje, e rritun
asht ndija ime n'shembujt e lavdishëm
kudo mendja ndriçoi filosofike.²⁰*

Këtu shpreh vizionin për Evropën e Bashkuar, ku shqiptarët do të ishin të barabartë krahas popujve të tjerë; e kujton që është shqiptar, bir i vendit mbi të cilin është provuar lakmia e fqinjëve:

*Ndofta një ditë, jo larg kufinjt do t'hiqen,
kur mendja e çveshun prej idhujve t'fundëm
t'bahet e zonja kthielltas me gjykue
me simpathi ma t'gjanë njëmend njerzore.²¹*

Po deri atë ditë, poeti thotë se të gjithë patriotët shqiptarë t'i dalin zot këtij vendi të trashëguar, edhe pse nuk është i plotë. Këto janë viset e Avni Rrustemit, të Çerçiz Topullit, të Naimit, Çajupit e Papa Kristo Negovanit, të cilat i trashëgojnë deri në ditët tona trimërinë epirotase. Poeti është që lavdia e lashtë e ilirëve të ngjallet edhe në ditët tona; ai bën thirrje që t'i dilet zot vendit, që të mbrohen trojet kombëtare.

Në fund, poezia e gjatë mbyllet me besimin se Shqipëria nuk do ta pësojë për disa tradhtarë, dhe se flamuri i Skënderbeut do të valëvitet në këto troje deri sa të ketë edhe flamuj të tjerë në botë. Ndërsa, sa i përket një grushti atdhemohuesish e tradhtarësh, sigurisht që Pipa këtu aludon te disa shqiptarë në emigracion, të cilët, kinse duke e luftuar komunizmin në Shqipëri, u dalin në krahë të të huajve, me këtë rast grekëve, të cilët synonin të merrnin jugun e Shqipërisë!

b) Narracioni për jetën në burg

Në “Librin e burgut” të Pipës, pikëshikimi i jetës s'ka si bëhet ndryshe, përveçse nga burgu. Poeti, çdo gjë që sheh, e sheh nga burgu. Edhe mendimet që pikënisjen e kanë nga burgu, edhe kthimin e kanë në burg.

Në “Librin e burgut” gjejnë strehë preokupimet e krijuesit në hapësirat e ndryshme: herë në qeli, herë në kamp, herë në qoshen e spitalit të burgut, ku i vuajnë dënimet e tyre afatgjata. Zakonisht, ata, në vargjet e tyre, japin momente nga jeta në burg, përjetimet e tyre në hapësirën e

²⁰ Po aty, f. 351.

²¹ Po aty, f. 352.

burgut, ndonjë moment të veçantë të jetës së tyre në burg, ndonjë ngjarje etj.

Jeta e burgut në “Librin e Burgut” të Pipës jepet nga pjesa e dytë, “Durrës, burgu i sigurimit” (Prill – Tetuer 1946).

I burgosuri, zakonisht, më së shumti e përjeton ditën e parë apo natën e parë të burgut, sepse ajo është një ditë apo një natë ndryshe nga ato që ka përjetuar deri në momentin që e përjeton burgun. Prandaj edhe poezia e parë e Pipës për burgun është soneti “Nata e parë”, në të cilën poeti e jep hapësirën e burgut: një kuzhinë që prej kohës nuk përdoret, një llambë vajguri që digjet me blozën. “E mbyllun dera, t’mbylluna dritoret”, kjo është hapësira në të cilën tani e tutje i burgosuri duhet të kalojë kohën:

*Grumbuj hijesh ngjeshun për rranza muri.
Nji qyp mbas dere. Aty pranë lëvoret
e nji qepe. Nji mi bren nëpër koret
e shpërndamë. Dikush pin prej paguri.*

*Lëvizin hijet, dalin me kureshtje
(Nata e parë)²²*

Siç thotë poeti në shënimin lexuesit në krye të librit, ky libër është një kronologji, po e cila prishet herë pas here. Pas natës së parë, vjen agimi: “Agime qi nuk shifen/ por veç ndigjohen./ Gjum, ankth, andrra qi shkrifen/ trembshëm... Ngatrohën”.²³ Nga dritarja e burgut sheh në një dritare një femër të panjohur, së cilës, në vete i lutet të mos e mbyllë dritaren dhe të mos e shuajë llambën.

“Ndërsa tregon për dhunën, të dhunuarit, dhunuesit, mjetet dhe mjedisin e dhunës, uni poetik shpesh ndalet dhe me lirizmin e tij të butë na tregon një botë tjetër, atë të shpirtit të tij të ndjeshëm, në një kontrast të thellë me urrejtjen klasore, dhunën, mjerimin, zvetënimin që vlon në burgje e kampe përqendrimi”.²⁴ Një gjë e tillë ndodh në poezinë e katërt të kësaj pjese, kur në mbrëmje, nga ballkoni i burgut, poeti mediton për jetën: “Përmallshëm sonte mbramja e majit ulet/ mbi zemrën e molisun

²² Po aty, f. 259.

²³ Po aty, f. 260.

²⁴ Yzedin Hima, *Letërsia e penguar dhe mitet e saj*. ISKK, Tiranë 2016, f. 65.

mbrenda gjinit/ n'sa puhija e larg erandshëm lulet/ shkunden të blinit".²⁵ Njeriu i jeton çastet dhe sipas çasteve ndihet mirë apo keq. Një çast kur ndihet mirë poeti është momenti kur sheh një vajzë përtej telave, i cili e bën të harrojë gjendjen në të cilën ndodhet:

*O zot! sa e ambël jeta ktu mas prakut
e mbyllun me tela... ku përtej shikon
nji hije t'epët vajze ndaj parmakut
mbi nji ballkon.
(Llampa)²⁶*

Poezi ku jepen momente të jetës në burg janë edhe poezitë: "Te shkolla", "Kënd spitali", "Prendvera e të vorfënve", "Mandi" etj.

Në të parën, "Te shkolla", poeti jep momente kur te shkolla ku ka punuar dikur, i sjellin të burgosurit për të bartur gurë dhe për të shtyrë vagonë. Ai me shokë është brenda telave, ndërsa njerëzve jashtë telave u thonë t'iu rrinë larg këtyre, se janë kriminelë! Por ajo që i bën një ata që janë brenda telave me ata që janë jashtë, janë këngët atdhetare që i këndojnë të burgosurit.

Në poezinë e dytë, subjekti lirik e sheh pranverën nga spitali i burgut, pastaj e sheh veten "mbyllun prej katër muresh". Nga dritarja e spitalit ai mund të shohë edhe njerëz që dikur edhe ata kanë qenë të burgosur!

Njeriu, i shkëputur me dhunë nga rrjedha e jetës së përditshme, me çdo mënyrë bën përpjekje që t'i rikrijojë këto lidhje. Mjafton një zë nga jashtë, një zë zogu apo zë fëmije, mjafton një pamje nga jashtë; mjafton rënia e shiut apo e borës, mjafton një pamje që sheh për të rikrijuar ato lidhje apo për të kaluar në kujtime të së kaluarës, të cilat i kundërvihen shkëputjes me forcë nga rrjedha e jetës.

Për punën që bëjnë në burg, poeti jep pamje në poezinë dypjesëshe "Kanga e verës". Të burgosurit shkarkojnë kamionët e mbushur me gurë, të cilët pastaj i thyejnë me çekanë e vegla të tjera. Në atë mjegull pluhuri që ngrihet nga shkarkimi dhe thyerja e gurëve, e sheh fytyrën e vajzës së dashur:

²⁵ Arshi Pipa, *Poezi*. "Dukagjini", Pejë 1998, f. 262.

²⁶ Po aty, f. 262.

*O syt e tu ndër lotë e buza e qeshun!
Ma ndrisin natën e shpellës ma mbushin.
E puthi prangat për gërshetat tua.²⁷*

“Kënga e verës” e ndërlihdh subjektin lirik me emrin e një vajze me emrin Verë, të cilën ky sigurisht që e ka dashur para se të futej në burg. Jo rrallë poeti shprehet edhe për vendin ku i krijon vargjet e veta:

*Ktu para kërcinjsh e femurësh
e nofullash me dhëmbë e brinjsh e kërbishtash,
para gropave t’errta synore
qi duket se kqyrin kërcënueshëm,
unë, poet i hares para mortit,
endi mbas rythmit qysh tundet lopata
kto vargje me rimat e shortit,
ndër krismat e thata
prej kazmash ndër rrashta kur qiten përjashta,²⁸*

Ritmi i kazmave dhe i lopatave sikur i jep ritmin kësaj poezie.

Kënga e një zogu, zogu që këndon të burgosurit, që i tregon se jashtë jeta vazhdon, poetit të burgosur ia ngjallë dëshirën për të jetuar i lirë. Zogu këtu personifikon lirinë e të jetuarit. Pas zogut, diku sheh një stan, shqerrat që lozin njëra me tjetrën, pastaj kujton erën e tokës së hapur nga parmenda. Pra jashtë “ngazllon prendvera, dalldiset nga hareja”, dallëndyshet bëjnë foletë e reja dhe në fund shihen duke ardhur edhe familjarët e të burgosurve, të cilët i presin me padurim për qindra arsye:

*Ka çelë mbi shkam lofata. Fryn era e butë e detit
tue bartun mera t’imta. N’oborret e qytetit
lëshojnë hije mandat. Shif! gjelbëroi gjithë shpati!
Nji tufë, si re, pëllumbash po vjen nga Dunavati!
(Dita e takimit)²⁹*

²⁷ Po aty, f. 278.

²⁸ Po aty, f. 281.

²⁹ Po aty, f. 262.

Jo rrallë, në përshkrimin e burgut apo të skenave që ndodhin në burg, sidomos në vargjet sonetike, në makabritetin që ndodh aty, vargjet danteske i vijnë në ndihmë poetit.

*Lamsh na përlanë – çka mundëm me rrëmbye
prej teshash vrik – e na stivuen si thasë
ndër kamjona, me shqelma tue na rrasë;
prangat ndër duer, për s'mrapshti, ashtu mbërthye*

*si mishi u nxi mbas pakë e u fry me plas;
mandej për kambë e gjoks litarin nye
tri herë na e përshkuen, tue u-ndërkrye
ma keq mbi kë u-ankuee desh t'u flasë.
(Nisje)³⁰*

Skenat janë groteske Edhe hapësira e poezisë së Pipës i ka shenjat e hapësirës danteske. Ja si e përshkruan natyrën që e rrethon burgun e Burrelit:

Nesrej oborrit njohim: pa një gjeth,

*Nji pus aty, pa grykë, pa enë, gavetë,
Llakaçiten për uj tue u-shkapetë.
(Burgu i Burrelit)³¹*

Në poezinë “Mbarim tetori” jep atmosferën e lajmërimit të dimrit, atmosferë kjo që tek të burgosurit ngjall trishtim. Pra është atmosferë e kundërt e ardhjes së pranverës, e cila jo vetëm natyrën, po i ngjall edhe të burgosurit. Poeti që ka qëndruar për dhjetë vjet në burg, i ka përcjellë vazhdimisht stinët, ndryshimi i të cilave sjell ndryshim në shpirtin e të burgosurve.

c) Poezia për poezinë

Arshi Pipa, krijimin e poezisë në burg e kishte bërë, ndër të tjera, edhe me një qëllim: nëse nuk do të arrinte të dilte vetë nga burgu, së paku

³⁰ Po aty, f. 385.

³¹ Po aty, f. 386.

të dilte poezia e tij. Në fjalën që i paraprin librit, Pipa thotë se as që e kishte ëndërruar që një ditë do të gjendej në SHBA, sepse mundësia për të vdekur në burg ishte më e madhe se mundësia të dilte gjallë nga burgu: “Dhe ky libër u nis bash me qëllim qi të delte ai nga burgjet prej të cilave un ndofta nuk do të delsha”.³²

Ashtu si në poezinë e realizmit socialist që hasim mjaft vargje për poezinë, të cilën poetët e vënë në shërbim të organizimit shoqëror, edhe në poezinë e burgut e hasim këtë temë, po tani të lidhur me fatin e të burgosurit. Temën e poezisë e hasim edhe te Pipa, i cili, ende pa rënë në burg, ishte poet.

Edhe pas Pipës jo pak të burgosur ishin poetë që ishin dënuar për arsye politike, por edhe për arsye poetike: se kishin devijuar nga realizmi socialist. Këtyre poetëve, tani në burg, u vjen në ndihmë poezia, e cila i shoqëron kudo që janë, u jep forcë për të përballuar vuajtjet që i përjetojnë, u ngjall shpresën për jetë, i bën të krahasojnë jetën e tyre me jetën e paraardhësve të tyre krijues, paraardhësve që kishin përjetuar vuajtje të ngjashme.

Në poezinë e Pipës, shpirtin e vet subjekti poetik e krahason me zhvillimet e fenomeneve natyrore: tallazet e natyrës i shëmbëllojnë me shpirtin e vet dhe një zë i brendshëm, që të mos frikësohet nga këto tallazet, i thotë se ashtu si i mbyturi në det që shpëtimin e ka tek anija, ky e ka te kënga:

*Por ti ke kangën tande si anija
qi vjen për lundërthymin.*³³

Pika nga sheh, mendon apo revoltohet subjekti lirik në shumë poezi të këtij vëllimi, është nga pozita e poetit të burgosur nga regjimi diktatorial:

*Shifni këto duer qi rrokin sot këtë pendë
jo ndryshe por si kamë,
si kamë e ngjyemë n' gjakun qi ktu mbrendë
farmak qyshkur asht bamë,*³⁴

³² Po aty, f. 243.

³³ Po aty, f. 278.

³⁴ Po aty, f. 289.

Ma poshtë:

*Eni ta shifni m'at ditë poetin
si shkruen me shkronja zjarri
poemën e liris qi ngjall vullnetin
e kombit thellë prej varri!*³⁵

Poeti i bën thirrje popullit që ta shkulë atë bimë të keqe se, përndryshe, ajo do ta marrë krejt arën!

Rendin shoqëror, të krijuar në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore, e quan “pus llahtarije”,³⁶ që i është bërë kurban Mollohut rus dhe i bën thirrje perëndisë ta shuajë këtë farë të keqe; jo duke e vvarë, po ta lërë të gjallë të shpërndarë nëpër botë dhe të turpëruar. Në fund, Zotit i bën thirrje t’i shkatërrojë këta njerëz që nuk besojnë në Zot!

Burgosja ia shkëput njeriut fijet e lidhjes me jetën e natyrshme, të cilën e ka bërë deri në momentin e arrestimit. Në një gjendje të tillë, poetit poezia i shërben për të mos i ndërprerë këto fije:

*unë, poet i hares para mortit,
endi mas rythmit qysh tundet lopata
kto vargje me rimat e shortit,
ndër krisma të thata
prej kazmash ndër rrashta kur qiten përjashta.*³⁷

Gjatë kohës sa e jep në vargje jetën që bëjnë të burgosurit që hapin kanalin në kënetën e Maliqit, poeti përsiat: jo vargjet, po proza është lloji i përshtatshëm për ta dhënë këtë jetë në gjithë kompleksitetin e saj:

*Proza, jo vargu i mallëngjyem lirik,
t’i thotë me rend të gjitha sa ktu pati:
t’i çohen flokët, t’përqethet shtati
kujdo lexon kanalin satanik.*³⁸

³⁵ Po aty, f. 289.

³⁶ Po aty, f. 289.

³⁷ Po aty, f. 281.

³⁸ Po aty, f. 304.

Poezia e fundit e pjesës së pestë të “Librit të burgut” të Arshi Pipës është “Ode poezisë”. Në këtë poezi njëzet strofash gjashtëvargëshe, poeti i kthehet edhe një herë poezisë, e cila, sa kishte qëndruar në burg, gjatë ishte larg poetit dhe ai kishte frikë se po i ikte përgjithmonë, po tani, aty ku dergjet, i kthehet: “o ti e vetëm e ngeluna/ prej çdo tjetër hareje./ sublime ndër vargoj!”³⁹ E vetmja hare e poetit, sublime ndër vargoj, është poezia. Nga mungesa e poezisë, e frymëzimit, ndjenjat kishin filluar t’i ftohen poetit, por tani poezia del “prej hijeve” e vjen te poeti dhe çdo gjë kthehet si më parë: e kthen poetin në jetë, i jep forcë për të jetuar:

*M’u-çelën syt e mjegulla
m’u-davarit qi shqiset
pat errun... m’u-rënqeth
shtati deri ndër fijëzat
ma t’imtat, thue po grisit,
e zemra u-shkund si gjeth*⁴⁰

Në vazhdim, subjekti poetik “rrëfen” brendinë e vet, ndryshimin që bëhet në shpirtin e tij kur i kthehet poezia, kur i kthehet frymëzimi: dhoma mbushet freski pranverore, kraharori i dehet, zemra i hov si laresha në agim. Poezia është: “Nevojë qi dukesh trill!” dhe ajo tani e ka freskinë e kohërave të mëparshme, kur poeti nuk ishte i burgosur, kur dija e tij kishte zënë fill. Jo vetëm kthehet në rininë e vet, por kthehet edhe në rininë etnike, në lashtësinë ilire dhe kujton pyllin ku orakullin e hershëm e pati Dodona dhe të parët tanë, të cilët, edhe pse paganë, besuan në një zot, ndërsa muzën e vet e krahason me hyjneshat e Akropolit:

*Hijen e randë e vetullat
e vranta nga mendimi
zbuti ti sa një ças!
Shif si falen mes tyneve
majet! I ngjyen agimi
prej Sharit n’Parnas!*⁴¹

³⁹ Po aty, f. 343.

⁴⁰ Po aty, f. 343

⁴¹ Po aty, f. 344.

Çfarë është poezia sipas subjektit poetik? Poezia është shpërblim hyjnor, prej të cilit tingullin ta bie të varfër fjala! Poezia është ngazëllim e pasion, që të përvëlon më shumë se çdo puthje që mund të të përvëlojë! Krijesën që i lind nga kthimi i frymëzimit poeti e quan “epithalam”, këngë dasme, dhe rreket të hetojë çfarë është krijesa që lind nga frymëzimi: mos është ndonjë flatër e mallit në idilin që nuk u realizua apo shpirti i motrës së vdekur? Edhe Pipa rreshtohet me mendimtarët se përpjekja për ta kuptuar poezinë është e kotë, ajo vetëm ndihet:

*Por kot, na kot orvatemi
me ta zbulue bërthamzën
n'andrrat ku ke fole.
E duhet të kënaqemi
me t'ndie veç si hare. – ⁴²*

Me këtë frymëzim, subjekti poetik thotë se do të hyjë në thellësi të ujërave të fjetura, aty ku “gjindet diamanti”, ta nxjerrë, e ta qesë në dritë:

*E pasjonin e shpirtënave
qi u-shkrinë për të vërtetën
e për artin sublim
ta ngjalli përmes tingujve
qi bota për gjithë jetën
t'u falet me nderim. ⁴³*

Veten e emërton lundërtar i cili të bukurën e kërkon në sfida të vështira, lundërtar që të bukurën, më në fund, e gjen të “adhurueme vyrtyt”:

*Nji dije gjeta t'epërme
qi botën ma ban timen
ndër brenga si n'gazmend;
mi shlyen kufint kah ndaheshin
dhe ma të pasun rimën
ma ban me shqisë e mend. ⁴⁴*

⁴² Po aty, f. 345.

⁴³ Po aty, f. 345.

⁴⁴ Po aty, f. 345.

Credoja e poetit: poezia e poetit shkruhet me strofa e me maturi klasike. Në poezinë e tij do të rrjedhin mendimet më të ndritshme e ndjenjat më fisnike, mësim për çdokënd:

*Eja ma shpesh, o e bukura
motër hyjnore, eja
për t'amblin frymëzim!
qi këtë dhuratë të zotave
të lashtë me fjalë të reja
t'ja kthej un kombit tim.⁴⁵*

Pipa, edhe pse në vazhden e Lasgush Poradecit, nuk ngjall fjalë plaka. Ai, frymëzimin dhuratë e zotave të lashtë, popullit të vet, do t'ia kthejë me fjalë të reja.

ç) Filozofia stoike në poezinë e Pipës

Vargjet meditative filozofike të poetit, në “Librin e burgut”, shpërthejnë zakonisht kur poeti mediton për natyrën, për stinët, për ndryshimet që pëson natyra nëpër stinë dhe së bashku me të edhe njeriu. Në thelb të filozofisë së Arshi Pipës është filozofia stoike, ndërsa njëra ndër poezitë ku shprehet kjo filozofi është “Kënga e vjeshtës”.

Njeriu është qenie e krijuar nga natyra si të gjitha qeniet tjera: kafshët, bimët, zogjtë etj., prandaj edhe uni poetik i poezisë së Pipës te vetja sheh analogjitë me krijesat tjera natyrore, sidomos me drurët dhe, ashtu si pemët që i pranojnë ligjet e natyrës, pa smirë, edhe shpirti i poetit i pranon ligjet që e qeverisin botën njerëzore, ai është i bindur se e ka kryer detyrën e vet dhe që humbja e tij është në këtë jetë, në të sotmen, po jo edhe “te rendi i amshuem”. “Shif pastaj!..” pra të mos shoh njeriu vetëm në të sotmen, po të shohë përtej.

Në ciklin e pestë, “Durrës, burgu i spitalit”, korrik 1949-janar 1950, me gjithsej katër poezi: “Epshe”, “Lamtumirë”, “Andrra e Evës” dhe “Ode poezisë”, poezitë janë më shumë meditative filozofike. Një gjë të tillë e kushtëzon edhe jeta e të burgosurit në spital, përreth gjysmë viti.

Në poezinë e parë “Epshe”, me pesëmbëdhjetë strofa, poeti përsiat për epshe, të cilin e emërton si një helm të rrallë, të pacilësuar, që nuk ka

⁴⁵ Po aty, f. 346.

emër, po që gjendet anakënd i përhapur te qenia e njeriut: “i mbrumë me gjak, i ngjeshun mish ndër indet,/ i shkrimë me lotë”:

*Gjarponon trupi i naltë hollak, përhidhet,
thehet te beli e hovin gjinjtë e paktë,
shkundt kunora e flokve e barku dridhet
i rrumbullaktë.⁴⁶*

Epshi që gjendet në trup, shpërthen jashtë: del prej flegrash si afsh, del si avull nga goja dhe nga çdo pore mishi, nga jargët e gojës njelmët shijon, ndërsa nga puthja aromë hashashi. Nga epshi trupi dridhet: gjarpëron trupi hollak, përhidhet, thyhet te beli dhe hovin gjinjtë e paktë. Nga përshkrimi i trupit, kalon te përshkrimi i syve, sepse ajo që është brenda qenies njerëzore më së miri pasqyrohet te sytë; pastaj te goja: fillon të flasë, po fjalët janë pa kurrfarë kuptimi, janë të mangëta, janë vetëm tinguj, “jone sirene”, si ky zë tani, që “kusarisht” hyn ndër pore:

*e hin ma thellë e bredhë e shket gjithkah,
si duer, si krahë⁴⁷*

Nga brendësia, poeti kalon në përshkrimin e jashtëm të atij/asaj që është mbërthyer nga epshi; mollëzat e fytyrës të groposura prej pasionit, të zbehta, të pagjak sikur ato të ikonave në kisha, goja hapet jashtë zakonit; një shpërfytyrim i qenies njerëzore të mbërthyer në botën e epshit; dhëmbët e çeliktë, buzët e fryra ngjyrë vjollce, nofullat që i ngjajnë gjarpërit, si hidhet “bisha” që ka zënë vend te njeriu!

Epshi këtu jepet një herë në brendinë e njeriut, pastaj si shfaqet, si shpërthen, si e shpërfytyron njeriun e mbërthyer dhe si përfundon ky njeri. Në disa aspekte, kjo poezi na e kujton poezinë e Migjenit, në të cilën jepet bota e njerëzve të mbërthyer nga epshi: brendësia si dhe jashtësia e njeriut të mbërthyer nga epshi. Nuk mjaftojnë as fjalët e poetit, i cili shpreh dhimbjen për ata që i mbërthen epshi: mjerë ai që me shpejtësi nuk i shmanget botës së epshit:

*Kthetrat e saj i ngulen n'mish mizore,
e birret e përpimë n'at puthje goje*

⁴⁶ Po aty, f. 323.

⁴⁷ Po aty, f. 323.

*si n'gjertore.*⁴⁸

Pasojat nga epshi i jep në shumë strofa të kësaj poezie, për të përfunduar:

*Ashtu te nata e zjarhtë e mishi qorr
gulshon epshi me pezëm e furi.
Mandej asht agoni... mandej asht vorr...
e neveri.*⁴⁹

Në poezinë “Vjeshta e dytë”, të shkruar pas daljes nga burgu, poeti jep pamjen e pemëve pasi janë liruar nga frutat në vjeshtë:

*Janë tani vetëm për vete,
të bukura e të kota,
lirue nga barra e fryteve.*⁵⁰

Është një ditë me diell vjeshte, një qiell pa re, një qetësi që mbretëron në natyrë, e cila subjektit poetik i ngjall “nji ndije t’ambël pranije”, e cila shëmbëllen me amshimin. Prej të gjitha stinëve, subjektit poetik i pëlqen vjeshta, sepse, siç thotë, vjeshta është një stinë në të cilën ai mund t’i gëzojë rrezet e ngrohta e gjethin e gjelbër “tu harrue/ pakuptimin e qenjes”.⁵¹

Me daljen nga burgimi dhjetëvjeçar, poeti sikur ndien një zbrazëti në shpirt, sikur është i liruar nga ato “fryte” që i ka bartur me vete për aq kohë.

Dy poezitë e fundit të ciklit të dytë janë “Shpresë” dhe “Kanga symbolike”. Në të parën, “Shpresë”, jepet qëndrimi i të rriturit ndaj shpresës, i njeriut që ka një përvojë jetësore. Kjo poezi është prej atyre që poeti i ka krijuar më herët, por që tani në burg i rikrijon edhe një herë përmes imagjinatës së vet. Në këtë poezi, si edhe në disa poezi të tjera, poeti është mendimtar, ai përsiat për jetën, për botën, për qenien, për dashurinë: ç’janë ato?

Kur njeriu rritet, shpresa më nuk i sjell ëndrra të bardha të një mëngjesi maji, të tilla që i sjell kur ishte fëmijë, kur ende nuk e dinte

⁴⁸ Po aty, f. 324.

⁴⁹ Po aty, f. 324.

⁵⁰ Po aty, f. 428.

⁵¹ Po aty, f. 428.

çfarë është faji. Pra vetë rrita është njëloj faji më vete për njeriun. Por, tani, kur edhe në këtë moshë, ëndërra që “ruhet” për t’i dhënë atij vegimin e një bote të lumtur, por që shpejt shuhet, pasi një namë fatale, e cila nuk mundet të zhvillohet ndryshe, por vetëm duke “përlyer”, i shkatërron të gjitha ato që ishin burim i shpresës për ideale, njeriun e rritur e mllëfos.

Kush është kjo “namë fatale” “qi s mundet me zhvillue veç tue e përly”?

Kur arrin në këtë pikë, pasi përballet me namën fatale, subjekti lirik i drejtohet shpirtit të kulluar: “Shpirt i kulluet qi dashamir përndaresh,/ aq pafajni hareje/ si mundesh me na dhanë/ te bota jonë e mangët, e dështueme?”⁵² Pra, si na dorëzon ky shpirt te një botë e cila është e mangët, e dështuar? Nga bota, ku e ka “lëshuar” shpirti i kulluar, subjekti lirik kalon te arti, te e bukura: “Ah, ndër sendet e bukura gjithfarësh/ ndjeva gjithmonë përmallshëm/ një t’drithun mrekullije/ gjithsaherë gand vezullimet e tyne/ m’i prekën t’imat ndije.../ te ti t’mbledhuna i ndesha/ si valavitje n’erë tingujsh t’bjerrun/ te një zhvillim i lidhun melodije”.⁵³

Te e bukura, tek arti, i gjen të gjitha të përmbledhura në një, pastaj flet për artin, për dashurinë ndaj të bukurës dhe artit, por krahas dashurisë për artin, të bukurën, letërsinë, i vjen një parandjenjë për diçka më të lartë: “...nji parandije/ për njitjetër, eprore,/ si n’andrrimet e dlira/ kah plotnija shpirtnore/ ku një veç janë e bukura dhe e mira,”⁵⁴

Ky subjekt synon diçka më të lartë, më të plotë, ku e bukura dhe e mira janë një: “diçka qi na zbulohet/ ndër shëmbëlltyrat e ndrrueshme veç pjesë,/ e rrezaton e tanë n’amshim t’ides”,⁵⁵ diçka që mund të shihet vetëm në pjesë dhe jo si tërësi.

Sipas subjektit lirik, dashuria, dashuria tokësore, është e bukur, është dashuri “...qi pemën/ e natyrshme përfton”, kurse ajo hyjnore është dashuria e fshehtë (e mërtisun), jo e hapur, “qi digjet tue u-zhgalë/ shterpe prore pa shpresën e bashkimit/ me sendin e gjakimit/ veç nëpërmjet mendimit t’arratisun”,⁵⁶ prandaj edhe subjekti lirik synon të bashkohet me dashurinë eprore, bashkim që bëhet vetëm në mendime “t’arratisuna” dhe jo drejtpërdrejt.

⁵² Po aty, f. 263.

⁵³ Po aty, f. 263.

⁵⁴ Po aty, f. 263.

⁵⁵ Po aty, f. 263.

⁵⁶ Po aty, f. 264.

Kështu, arrin te flijimi, i cili shqisave të rënda ua fal flakën që nuk shuhet, ndërsa fshehtësia e betimit i ruan të paprekura nga jashtë: “.....I falë/ flija e shqiseve t’randa/ flakën e blerë qi s fiket,/ dhe mësheftsija e bes/ e mbyll si ndër reliket. Qi s mund t’i çelin veçse duer vestalesh”.⁵⁷

Në vazhdim subjekti lirik flet për “nji martesë të pastër idealesh”, e cila ushqehet me mungesë. Bota e huaj është e pazonja për ta njohur ndjenjën e misterit, po edhe ti gjatë kësaj kohe nuk ke për të pasur më shumë se dyshime.

Në fund, subjekti lirik është i vendosur ta ruajë shpresën “...brenda meje pa përlim/ ditën tue pritë fatore/ kur vetë ke m’u-qasë,/ me sytë pa praskë, me zemrën pa lëvore,? Si mbrenda shpirtit tim banon e flen,/ si dikur, si rishtaz ke me qenë”.⁵⁸ Po çfarë do të ndodhë deri atëherë? “Por deri at’herë kjo qoftë/ ligja e vështirë qi i ven vetes mungesa./ Ta dliirë pamjen largesa,/ ta shton veskun e dashun, tue shpërblye/ me kthjellimin e mallit te kujtesa/ çka shqiset patën fye”.⁵⁹

Poezia fillon me skepticizmin ndaj shpresës tokësore, për të përfunduar me kthimin te një shpresë tjetër, që është më e lartë, e cila nuk cenohet nga të ndodhurat në tokë, te një shpresë që nuk ka mort.

Poezia tjetër, “Kanga symbolike”, në dymbëdhjetë katrena, është një përsiatje e subjektit poetik për rrugën të cilën me vullnetin personal ai e ka zgjedhur:

*Shortin e dhimbës vetë me dashje e zgjedha
kur lashë andrrimet për me njoftun jetën,
aty ku vlojnë u-hodha
epshet njerëzore me kërkue t’vërtetën.*⁶⁰

Po, sipas këtij subjekti e vërteta, përkundër artit që e kishte puthur ëmbël në rini, kishte shije të hidhur!

Në strofat në vazhdim tregon për rrugën të cilën e kishte ndjekur për të gjetur të vërtetën; nuk i kishte pëlqyer realiteti tokësor, prandaj kishte synuar diç më të lartë, që në poezi metaforizohet me ajrin e pastër të maleve.

⁵⁷ Po aty, f. 264.

⁵⁸ Po aty, f. 264.

⁵⁹ Po aty, f. 264.

⁶⁰ Po aty, f. 266.

Shpirti i tij krijon ura të reja në drejtim të së panjohurës: “njif e guxo” është religjioni i këtij shpirti, dhe se guxon ai i cili do të jetë i pavdekshëm. Pra ky është një lundërtar të cilin nuk e tremb stuhia; është kundër shpifjes dhe anatemimit që i bëjnë:

*Ti mirë e din si janë shpërblye me ferrin
ata qi qiellin çemën.
Urren dritën i rysuni me terrin.*⁶¹

Poezia përfundon me porosinë se njeriu, më shumë se veten, duhet ta dojë të vërtetën:

*Qëndro me paqe, qëndro si shkamb qi vala
rreh me furi pa mund andej me e shklye.
Qëndro me besë se fjala
qi i shpalle dheut një ditë ka me u shpërblye.*⁶²

Fundi i kësaj poezie na kujton poezinë e Luigj Gurakuqit “Qindresa”. Edhe ashtu, Pipa është vazhdues i denjë i poezisë rilindëse e post-rilindëse të Shkodrës. Po poezia e Pipës na kujton edhe filozofët stoikë të lashtësisë, Senekën, Epiktetin etj. Dhe jo vetëm në poezinë e Pipës, sepse, edhe pse poetët e burgosur dallojnë në mënyrën e të krijuarit, dallojnë në stilet e tyre dhe ndjeshmërinë, ngase krijojnë të izoluar nga njëri-tjetri, filozofia stoike është ajo që i bashkon.

3. Poetë të tjerë

Kasem Trebeshina. -Shkrimtari kontrovers Kasem Trebeshina (1926-2017), i cili nga person ushtarak gjatë luftës, pas luftës kaloi në fushën e artit e të kulturës, ndërsa në vitet '50 ra ndesh me regjimin që ishte vendosur në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore.

Daljen nga sistemi të cilit i kishte shërbyer të ngadhënjente, Kasem Trebeshina në mënyrë alegorike, e paralajmëron në poezinë “Çimkat”, të cilën e kishte shkruar më 1953: Ndërsa subjekti poetik fle, insekte që e kafshojnë ia nxjerrin gjumin. Ai zgjohet, ndez pishën dhe e sheh që nga tavani mbi të grumbuj-grumbuj bien çimka. Ngrihet dhe vret sa të mu-

⁶¹ Po aty, f. 267.

⁶² Po aty, f. 267.

ndet, po pasi ato janë shumë, ua fut flakën: “Pash çfar pash, i vura zjarrin:/ dogja çimkat me shtëpi!”.⁶³ Në të vërtetë, poeti nuk i kishte djegur çimkat, po kishte ndodhur e kundërta – ishte burgosur e internuar.

Trifon Xhagjika (1932, është pushkatuar më 23 dhjetor 1963) ishte një shpirt i ndjeshëm dhe, për pasojë, edhe një lirik i hollë që flet me fijet e barit, me zogjtë, me hënën.

Nga dyzimi i qenies krijohet drama: njeriu duke u vënë përballë vetes fillon një dialog të brendshëm nga i cili lind poezia. Kjo përballje e njeriut me veten, që është në thelb të poezisë moderne, është edhe në thelbin e poezisë së poetit Trifon Xhagjika.

Maks Velo (1935-2020) është autor i një sërë botimesh si: “Kokë-qethja”, “Palltoja e burgut”, “Thesi i burgut”, “Paralele për arkitekturën”, “Kohë antishenjë”, “Betonizimi i demokracisë”, “Hetimi”, “Spaçi”, “Jeta ime në figura”, “Klubi Karavasta” “Përkthyesi”, “Jetë paralele”, etj.

Poezia e tij është poezi homazh për të gjithë të persekutuarit të cilët për dekada me radhë qëndruan në burgjet e kampet e Shqipërisë, një pjesë e të cilëve nuk arritën të dalin gjallë.

Visar Zhiti (1952). -Nga tri vëllimet poetike të botuara në vitet ’90; “Kujtesa e ajrit” (1993), “Hedh një kafkë te këmbët tuaja” (1994) dhe “Dyert e gjalla”, e dyta është e tëra me poezi të burgut, ndërkaq e para dhe e treta pjesërisht ngërthejnë poezi burgut, po në to ka edhe poezi të para burgut dhe të pas burgut, të viteve ’90.

Krijimtaria e Zhitit, që me një fjalë e ka emërtuar “burgologji”, përfshin një krijimtari në vargje e në prozë, po edhe me studime nga burgu dhe për burgun.

Përfundim: Vendi i Pipës në poezinë shqipe

Arshi Pipës edhe sot nuk i jepet vendi i merituar në letërsinë shqipe. Vepra e tij, poetike e kritike, vetëm pas rënies së komunizmit u botua në Shqipëri e Kosovë, sepse para kësaj kohe në Shqipëri kjo vepër ishte e ndaluar, pasi Pipa ishte armik i regjimit; po as në Kosovë nuk u botua, edhe pse këtu Pipa nuk kishte ndonjë problem me regjimin.

Mungesa e afinitetit ndaj poezisë së Pipës në gjykimin për veprën e tij vjen nga mungesa e gjatë e pranisë së kësaj vepre në letërsinë shqipe, po kjo mosprani nuk i arsyeton vlerësimet joadekuate për poezinë e tij,

⁶³ Po aty, Cituar sipas: Gjovalin Kola, *Shkolla e disidencës dhe Trebeshina*, f. 199.

ndër të cilat hyn edhe vlerësimi i Rexhep Ismajlit, dhënë në parathënien e botimit të poezisë së tij, më 1998, në Prishtinë. Sipas Ismajlit, “Libri i burgut’ lexohet më tepër si fragmente të një ditari tronditës poetik për fate të ndryshme njerëzish të thjeshtë, po edhe intelektualësh të shquar nën diktaturë, për fatin e një populli”.⁶⁴ Po nëse libri i Pipës mund të lexohet si “fragmente të një ditari tronditës poetik”, cili libër poetik i dekadës së parë të letërsisë shqipe, të shkruar pas Luftës së Dytë Botërore, është më i plotë dhe me nivel më të lartë artistik se “Libri i burgut” i Pipës?! “Libri i burgut” është libri i parë, po edhe më i ploti i krijuar në burg dhe i botuar jashtë vendit, prandaj mund të themi se, nuk ka vëllim poetik më të plotë, të botuar në gjysmën e dytë të shekullit të njëzet, se ky libër në letërsinë shqipe!

Një gjykues objektiv, që e vlerëson lart poezinë e Pipës është Gjovalin Kola: “Fryma kritike, kundërshtimi deri në sarkazëm është një tipar tjetër i kësaj lirike me fizionomi të dukshme politike e sociale. Larmia e strukturave strofike e ritmike, shumësia e temave e motiveve; nga ato etnike e filozofike e deri tek ato intime e bën Librin e Burgut një antologji poetike, ku jepen tonet e zymta të një realiteti shpirtëror, që ka përjetuar kufizime e vuajtje të jashtëzakonshme”.⁶⁵ Sipas Gjovalin Kolës, “Libri i Burgut i Pipës është poezi e imazheve të forta. Ai ngjan më shumë me një film bardh e zi, pa zë, ku dekoru vdekjendjellës i mureve e i qelive dylufton çdo çast me të burgosurit, që duan të mbijetojnë e të shpresojnë. Pikërisht këtë ndeshje të heshtur dhe pa kompromis mes këtij dekoru vrasës dhe personazheve që e popullonin atë ka përshkruar poeti, duke qenë edhe ai vetë aty brenda, protagonist e dëshmitar. Në këtë kuptim, ky libër mund të konsiderohet edhe si një himn për lirinë dhe dashurinë për jetën”.⁶⁶

Po ashtu edhe Leka Ndoja ka arritur të eksplorojë thellë në poezinë e Pipës për të dalë që andej me gjykime të larta për këtë poezi: “Pipa kalon nga deskriptivja në detajin nga detaji në të përgjithësim brenda një soneti të vetëm apo strofe, kjo e bën ‘Librin e burgut’ një narrativë polifonike në vargje”.⁶⁷ Duke e vlerësuar veprën poetike të Pipës, e ka krahasuar me veprën e Solzhenicinit për Gulagun rus: “Ky libër bën pjesë njëkohësisht në nënsistemin e librave të kujtesës, bashkë me “Arkipelagun

⁶⁴ Ftesë për lexim, shkruar nga Rexhep Ismajli (shih: Arshi Pipa, *Poezi*, “Dukagjini”, Pejë 1998, f. 17).

⁶⁵ Gjovalin Kola, *Shkolla e disidencës dhe Trebeshina*. “Plejad”, Tiranë 2012, f. 66.

⁶⁶ Po aty, f. 67.

⁶⁷ Leka Ndoja, *Letërsia e diasporës*. Shtëpia botuese “Pakti”, Tiranë 2015, f. 104.

gulak” të Sollzhenicinit për nga forca e realizmit dhe poetika danteske dhe faktet e sintezës dhe mesazheve universale përveç përshkrimit për-kujtues dhe çlirimit psikologjik të autorit në momentin e shkrimit”.⁶⁸

Me poezinë elegjiake, Pipa është në vazhden e Nolit; me sonetet në të cilat kujton lashtësinë trakë-ilire, është në vazhden e Ndre Mjedës, me poezitë-himne, në të cilat i këndon qëndresës njerëzore përballë tiranisë, të kujton poetët e shekullit XIX, Viktor Hygonë me shokë; ndërkaq, në tingëllimat në të cilat jep jetën e burgut, të kujton poetin e madh të Rene-sancës italiane, Dante Aligierin, sidomos kantikun e parë, “Ferrin”.

Në poezinë e shkruar nga poetët e burgosur bota vështrohet përmes antonimish, si antonimia në mes të hapësirës ku gjendet i burgosuri dhe hapësirës jashtë tij – natyrës, ashtu edhe antonimia në mes botës së brendshme të krijuesit dhe botës së jashtme, antonimia në mes të botës fizike dhe botës shpirtërore të krijuesit. Krijuesi, edhe kur është i lirë, bën një jetë antonimike në mes qenies së tij fizike dhe qenies shpirtërore. Ndërkaq, te krijuesi i burgosur antonimia në mes qenies fizike të tij dhe qenies shpirtërore, që mëton të jetë qenie metafizike, bëhet edhe më e ashpër. Krahasuar me krijuesin e lirë, tek i cili ka raste kur qenia shpirtërore mund të jetë në harmoni me qenen e tij fizike, te krijuesi i burgosur qenie fizike dhe qenia shpirtërore janë në opozicion të përhershëm

Sa i përket pyetjes që bëjnë kritikën përse Pipa mori sonetin për të krijuar ferrin e kampeve të punës, i cili në zanafillë është krijuar për t’i kënduar jetës, dashurisë, ata harrojnë që gjysma e sonetit përbëhet nga dy tercina: Pipa dy tercinave danteske ua shtoi nga dy katrena, me të cilat tani e krijoi në vargje ferrin e kampeve të punës në Shqipërinë diktatoriale. Sikur nuk i mjaftuan tercinat danteske Pipës për ta dhënë në vargje ferrin e kampeve të punës në Shqipërinë diktatoriale.

⁶⁸ Po aty, f. 104-5.

Bibliografia

Pipa, Arshi. -Libri i burgut, "Rilindja", Tiranë 1994

Pipa, Arshi. -Poezi. "Dukagjini", Pejë 1998

Trebeshina, Kasëm. – Polimnia dhe Melpomena. "Faik Konica", Prishtinë 2006;

Velo, Maks. – Kokëqethja. "Phoeix", Tiranë 1995;

Velo, Maks. – Thesi i burgut. "Phoenix", Tiranë 1996;

Xhagjika, Trifon. –Atdheu është lakuriq. Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1994;

Zhiti, Visar. – Kujtesa e ajrit. Shtëpia botuese e Lidhjes së shkrimtarëve, Tiranë 1993;

Zhiti, Visar. – Hedh një kafkë te këmbët tuaja (poezia e burgut: 1979 – 1987). Shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1994;

Zhiti, Visar. – Kohë e vvarë në sy. "Rilindja", Prishtinë 1997:

Zhiti, Visar. – Dyert e gjalla. "Eurorilindja", Tiranë 1995:

Literatura

Hima, Yzedin. - *Letërsia e penguar dhe mitet e saj*. ISKK, Tiranë 2016,

Kola, Gjovalin. - *Shkolla e disidencës dhe Trebeshina*. "Plejad", Tiranë 2012,

Leka Ndoja, - *Letërsia e diasporës*. Shtëpia botuese "Pakti", Tiranë 2015,

Pipa, Arshi. - *Poezi*, "Dukagjini", Pejë 1998 (shih: Ftesë për lexim, shkruar nga Rexhep Ismajli)

Zhiti, Visar. – *Panteoni i nëndheshëm ose Letërsia e dënuar*. "Omsca-1", Tiranë 2010.

"THE PRISON BOOK" BY ARSHI PIPA AND THE PRISON POETRY (1944-1990)

Summary

The Albanian literature of the second half of the twentieth century, in addition to the official side, also had the unofficial side, or better to say: in addition to the visible side, it also had the hidden side.

Parallel to the literature of socialist realism, which was installed after the Second World War in Albania as official literature, there were also created another literatures which were not controlled by ideological dogma. These literature were mainly: literature from the prison, literature from the files, and banned literature - that were created within the country, as well as literature of diaspora. While the literature of socialist realism interrupts the continuity of Albanian literature, the mentioned literature were the continuation of the Albanian literature from the years '30s-'40s of the last century.

At a time when the so called oriented literature enjoyed the respect of the ideologues of the new society of "equal" people, those who were not in the path of the oriented were punished by the power, were considered the enemies of the power - because in dictatorial powers, there are only two ways: you have to be with power or against it, there was no third way. At that time, when the dictatorship was installed in Albania, beginning of the end of the Second World War until the fall of communism in the early 1990s, among the prisoners, together with war criminals, the declassified, etc., a permanent presence in prison had the writers, some of whom did not even manage to survive. Among them were Ndoc Nikaj, Bernardin Palaj, Vinçenc Prendushi, Mirash Ivanaj, then later prisoner authors Arshi Pipa, Kasem Trebeshina, Lazër Radi, Kudret Kokoshi, Trifon Xhagjika, Genc Leka, Vilson Blloshmi, Havzi Nela, Frederik Rreshpja, Pano Taçi, Maks Velo, Zyhdi Morava, Visar Zhiti; in Kosovo Adem Demaçi, Xajë Nura, Adem Gajtani, Teki Dërvishi, Beqir Musliu, until the generation of 1981, as Hydajet Hyseni, Merxhan Avdyli, Januz Januzaj, Bajram Kosumi, as well as the prisoners of the 90s, of the war of KLA, 1997-1999.

Literature of the prisoner authors will be in the focus of this paper.

